



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOVOVO  
KOMUNA E VUSHTRRISË - OPŠTINA VUŠTRRI

01 Nr./ Br. 247/19

Nr. Fiq./ Br. sht. -17-

Data: / Datum 25.07.2019

VUSHTRRI - VUŠTRRI



REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

**PROCESVERBAL**  
**NGA MBLEDHJA E -VI- E RREGULLT E KUVENDIT TË KOMUNËS SË**  
**VUSHTRRISË, MBAJTUR MË 27 QERSHOR 2019**

*Mbledhja është mbajtur në sallën e Kuvendit Komunal, duke filluar në orën 10:20.*

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës në Vuštrri:  
Abdullah Vojvoda, Agim Bregaj, Agron Perçuku, Ali Januzi, Arta Ymeri, Bahrije Ademi Murati, Basri Menxhiqi, Ermal Lahu, Fakte Dushi, Fitim Halili, Fatmire Saraçi, Faton Shabani, Fjolla Ujkani, Gentiana Rama, Gresa Muli, Habibe Gërzhaliu, Hysni Gërguri, Ilmi Azemi, Kushtrim Hyseni, Hajriz Mustafa, Lorik Maxhuni, Mehdi Bejtullahu, Mejreme Ismajli, Melihate Basholli-Latifi, Miljan Bojković, Nasuf Aliu, Nezir Klinaku, Rrezarta Krasniqi, Sadije Bajgora, Safet Idrizi, Shkëlzen Feka, Shpëtim Zhegrova, Teuta Aruçi Shartari dhe Ymer Haradinaj.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe kryetari i komunës -z.Xhafer Tahiri, nënkryetari i komunës Besim Muzaqi, përfaqësuesi i KFOR-it, përfaqësuesi i OSBE-së, përfaqësues të mediave të shkruara dhe elektronike, përfaqësues të shoqërisë civile.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Nasuf Aliu – kryesues i kuvendit, i cili konstatoi se në sallë janë prezent 34 anëtarë të kuvendit, kuorum ky i mjaftueshëm për zhvillimin e punimeve të mbledhjes plenare dhe për marrje të vendimeve të plotfuqishme, andaj procedoi me rendin e ditës.

*Para fillimit të diskutimit lidhur me rendin e ditës Selim Rrustemi dha betimin para kuvendit duke u bërë anëtar i kuvendit me të drejta të plota.*

**Hajriz Mustafa, anëtar i kuvendit** - propozoi që të futet në rend të ditës propozim-vendimi për plotësimin e Komitetit për Politikë dhe Financa me një anëtar nga radhët e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës.

**Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit** - të nderuar qytetarë të Komunës së Vuštrrisë, të respektuar anëtarë të kuvendit, kryesues i kuvendit z.Aliu, kryetar i komunës z.Tahiri, nënkryetar i komunës z. Muzaqi, të nderuar të pranishëm! Zhvillimet e fundit në komunë do të duhej të ishin tregues i mjaftueshëm për koalicionin qeverisës, i cili do të duhej të heq dorë nga qeverisja me arrogancën e numrave. Natyrisht është e vetëkuptueshme se ky koalicion, e ka mandatin për të qeverisur komunën, por kjo nuk nënkupton që kjo qeverisje mund të bëjë çka të dojë dhe si të dojë, duke u mbështetur në fuqinë e numrave, duke anashkaluar dhe përbuzur çdo kërkesë legjitime të

qytetarëve dhe duke mbytur përmes pushtetit zërin opozitar. Por, kështu ndodh kur, në Kuvendin Komunal të Vushtrrisë mbizotëron një arrogancë e numrave e jo arsyeja e shëndoshë dhe idetë kreative. Në mbledhjen e fundit vetëm pse kisha një mendim të ndryshëm nga “shefi” i tij, kolegu im Fatoni, automatikisht më shndërroi në një përçarës, sado që mund të kisha të drejtë. I them Fatonit, por edhe Fatonëve të tjerë, se unë këtu nuk jam për ta përçarë askënd e aq më pak “martesën” LDK-VV, unë këtu jam sepse sovrani ka vendosur. Njëherë e mirë duhet ta kuptoni, se unë kur kam kërkuar besimin e qytetarëve për t’i përfaqësuar, fillimisht kam punuar që t’i njoh mirë përgjegjësitë dhe obligimet e mia, të cilat janë të definuara qartë me aktet juridike, siç janë:

- Ligjet që rregullojnë qeverisjen lokale;
- Legjislacioni sekondar për komunën;
- Statuti i komunës dhe Rregullorja e punës së kuvendit;
- Plani zhvillimor i komunës, por edhe
- Rregulloret komunale të komunës.

**Andaj të nderuar qytetarë të Komunës së Vushtrrisë,** duke iu referuar akteve të sipërpërmendura, konsideroj se: mbledhja e sotme bie në kundërshtim me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, më konkretisht, mbajtja e kësaj seance do të shkelte:

- Nenin 43, paragrafët 3,4 dhe 5 të Ligjit nr. 03/l-040 për Vetëqeverisjen Lokale;
- Nenin 45, paragrafin 4 të Statutit të komunës dhe
- Nenin 5, paragrafët 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr. 02/2015 për Mbajtjen e Mbledhjeve të Kuvendit Komunal.

“Neni 43 i LVL-së: Mbledhjet e kuvendit të komunës **paragrafi 3-** të gjithë anëtarët e kuvendit të komunës duhet të njoftohen paraprakisht me shkrim, ashtu siç kërkohet, shtatë (7) ditë pune para mbajtjes së mbledhjes. Në njoftimin e tillë shkruhet:

- a) data e mbajtjes së mbledhjes;
- b) koha e mbajtjes së mbledhjes;
- c) vendi i mbajtjes së mbledhjes;
- d) rendi i ditës për mbledhje, dhe
- e) materialet e mbledhjes.

**Paragrafi 4-** Njoftimi dhe materialet e mbledhjes duhet t’i shpallen publikut.

**Paragrafi 5-** Njoftimi nga paragrafët 3 dhe 4 të këtij neni duhet gjithashtu t’i dërgohet ministrisë përgjegjëse për qeverisje lokale.”

Duke qenë kështu, i nderuar kryesues, kërkoj nga ju që ta ftoni përfaqësuesin nga zyra ligjore, ta jap opinionin lidhur me këtë çështje. Thjeshtë, a qëndrojnë faktet e paraqitura dhe a quhet e rregullt kjo mbledhje e kuvendit të komunës (Materialin e kemi pranuar katër ditë pune para mbajtjes së seancës).

**Faton Shabani, anëtar i kuvendit** - tha se anëtari i kuvendit z.Klinaku bën gabim terminologjik, kur e quan “martesë” koalicionin aktual qeverisë për faktin se qeverisja aktuale e përbërë nga koalicioni nuk është martesë, por këtë ai e deklaroi me tendencë qëllimkëqija. Mandej ai vlerësoi se anëtari i kuvendit z.Klinaku në mbledhjen e kaluar të kuvendit në emër të VV-së dhe pa autorizimin e kësaj të fundit u mundua ta manipulojë kuvendin duke i premtuar mbështetjen e VV-së për AAK-në dhe për Idriz Asllanin, por fatkeqësisht edhe këta të fundit i ka manipuluar.

**Hajriz Mustafa, anëtar i kuvendit** - tha se grupi kuvendar i AAK-së nuk bie pre e asnjë manipulimi dhe se propozimi i Idriz Asllanit për çmimin “Nderi i qytetit” është bërë për faktin se ai e meriton këtë çmim.

**Agim Bregaj, anëtar i kuvendit** - pyeti se cilat kanë qenë kriteret për ndarjen e bursave në Komunën e Vushtrrisë.

**Gresa Muli, anëtare e kuvendit** - tha se rregullorja aktuale e bursave ka shumë mangësi sa i përket kriterëve për bursa, si p.sh aty thuhet se ndër kriteret që merret për bazë për ndarjen e burës është tek studentët që nuk i kanë prindërit në jetë, mandej studentët prindërit e të cilëve janë veteranë ju jepet përparësi. Andaj këto kriterë sikur e anashkalojnë kriterin e notës mesatare dhe kriteret tjera që është dashur të merren për bazë. Për këto dhe gjëra tjera ajo edhe në mbledhjet e kaluara kishte kërkuar që të ndryshohet Rregullorja për ndarjen e bursave. Në fund tha se si komision janë munduar që të bëjnë ndarjen më të mirë të mundshme duke u bazuar në kriteret e rregullores, por megjithatë kushdo që ka pretendime mund të parashtojë ankesë lidhur me ndarjen e bursave.

**Afrim Namani, drejtor i DA-së** - tha se rregulloren aktuale të bursave e ka aprovuar kuvendi i komunës, dhe në këtë rregullore ka disa kriterë që nuk është dashur të jenë, por derisa është në fuqi kjo rregullore na obligon për zbatim. Çështja e parë apo kriteri i parë që duhet të hiqet nga kjo rregullore është që studenti me automatizëm fiton bursën pasi ai ishte përfitues i mëhershëm edhe pse dihet se bursa përfitohet për një vit akademik. Në fund tha se deri më tani nuk ka pasur diçka të shkruar nga ndonjë komision për ndryshimin e kësaj rregulloreje.

**Albanez Tahiraj, zyrtar ligjor** - tha se në bazë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, statutit, dhe rregullores së punës së kuvendit, materialet e mbledhjes dërgohen 7 ditë para se të mbahet mbledhja e kuvendit. Pastaj sa i përket vonesave të këtyre materialeve vonesa të tilla ka pasur edhe në të kaluarën, por vazhdimi i kësaj mbledhjeje varet nga vullneti i anëtarëve të kuvendit.

**Shpëtim Zhegrova, anëtarë i kuvendit** - në reagimin e tij ndaj opinionit të zyrës ligjore, vlerësoi se këtu nuk u kërkuar të dihet se si janë mbajtur mbledhjet në të kaluarën, por çështja është se a ka shkelje ligjore sa i përket mbajtjes së mbledhjes së sotshme.

**Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit** - tha se zyra ligjore konstatoi se kjo mbledhje është duke u vazhduar në kundërshtim me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, dhe se ai nuk do të marrë pjesë në votim pasi një mbledhje e tillë është në kundërshtim me ligjin.

*Në vazhdim kuvendi me 34 vota “për” 1 votë “kundër” vendosi që mbledhja e kuvendit të mbahet.*

**Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit** - propozoi që në rend të ditës të futet edhe një pikë shtesë, informatë nga vlerësimet e gjetura të komisionit për verifikimin e shpërndarjes së subvencioneve dhe granteve.

**Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit** - propozoi që në rend të ditës të futet si pikë e veçantë menaxhimi i kontratave dhe analizimi i gjendjes në tërësi sa i përket menaxhimit të mbeturinave, për faktin se gjendja në kompaninë “Uniteti” është në një kaos të vërtetë pasi që komuna nuk është duke i kryer



obligimet ndaj kompanisë së lartcekur për gati 3 muaj dhe kontrata për shërbimin e mbeturinave është në prag të skadimit.

**Xhafer Tahiri, kryetar i komunës** – tha se grupi kuvendar i PDK-së, nuk dëshiron që të heq dorë nga ndikimi politik ndaj kompanive publike siç është rasti me kompaninë “Uniteti”, por megjithatë ai është i gatshëm që kurdoherë të diskutojë për këtë kompani, dhe sugjeroi që kjo të ndodhë në mbledhjen e ardhshme të kuvendit ku të gjithë do të përgatitshin me fakte për një debat substancial për gjendjen e kompanisë “Uniteti” në Vushtrri, si dhe do të diskutohej se si ka qenë gjendja financiare e kompanisë, kur ka ardhur në pushtet qeverisja aktuale dhe si është tani, se si është gjendja e shtrirjes së shërbimit tek qytetarët kur dihet se qeveria aktuale ka arritur që ta shtrijë ofrimin e shërbimit për mbledhjen e mbeturinave në tërë territorin e komunës. Mirëpo ai vlerësoi dhe bëri thirrje që të ndalet praktika e ndikimit politik në këtë kompani nga njerëz të caktuar dhe mos të udhëhiqemi nga inatet politike e personale dhe kështu ta dëmtojmë suksesin dhe të arriturat që janë bërë në kompaninë “Uniteti”.

**Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit** - tha se dëshiron që ta demantojë kryetarin e komunës për të pavërtetat e thëna për ndikimin në kompaninë në fjalë nga PDK, sepse kjo e fundit nuk ka kurrfarë interesi në këtë kompani, përpos që punët të shkojnë mbarë në kompaninë e lartcekur. Në anën tjetër atij i vjen shumë keq që kryetari i komunës, mbanë kesi lloj qëndrimesh jounifikuese në kuvend edhe pse është dashur të jetë e kundërta. Tutje shtoi se lidhja e jashtëligjshme e kontratave nga personi i paautorizuar e bën të dyshimtë këtë proces dhe shkaktimin e pasojave juridike nga ekzekutimi i pagesave, si dhe është proces i cili është duke u komprometuar dita ditës. Pavarësisht të gjitha këtyre ai pajtohet që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet për mbledhjen e radhës me kështu që të ftohet për raportim edhe shefi ekzekutiv i KRM “Uniteti” në Mitrovicë.

**Xhafer Tahiri, kryetar i komunës** – tha se në të vërtetë kompania “Uniteti” njësia në Vushtrri asnjëherë nuk i ka pasur punët më mirë dhe për këtë dëshmitarë janë qytetarët. Madje këto debate të sotshme dëgjohen nga qytetarët dhe veçmas nga punëtorët e kompanisë “Uniteti” të cilët e dinë se kompania atyre nuk u ka borxh as edhe një (1) cent dhe për këtë ndihet shumë i lumtur. Pastaj shtoi se taksat e qytetarëve të Komunës së Vushtrrisë, nuk lejon që të shkojnë në njësinë e kompanisë në Mitrovicë, që ata me këto para të pastrojnë rrugët nga bora në Mitrovicë nga taksat tona sepse kjo është e papranueshme. Mandej vlerësoi se si PDK-ja e ka lënë gjendjen në kompaninë “Uniteti” këtë gjë shumë mirë e dinë që të gjithë, pavarësisht se ai e ka përkrahur punën në hartimin e planit për mbeturina dhe punën me GIZ-in gjerman, si dhe punën e mirë të kryer nga shërbyesit civil të komunës. Lidhur me këto dhe çështje tjera i bëri thirrje grupit kuvendar të PDK-së që të heqë dorë nga politikat destruktive që e dëmtojnë kompaninë “Uniteti. Konkursi lidhur me pranimin në punë të shefit të kompanisë “Uniteti” në Vushtrri ka qenë konkurs i hapur, publik dhe i rregullt dhe personi që është pranuar është magjistër i shkencave dhe kjo bën që LDK-ja qeverisë me njerëz të shkolluar, për dallim prej të tjerëve.

**Melihate Basholli – Latifi, anëtare e kuvendit** - tha se nuk është me rëndësi se kur do të shqyrtohet informata për punën e komisionit lidhur me verifikimin e procesit të shpërndarjes së subvencioneve dhe granteve, por e rëndësishme është që të shikohet në detaje inspektimi i këtij procesi dhe të gjeturat lidhur me grantet dhe subvencionet.

***Në fund të diskutimeve jashtë rendit dhe për rendin e ditës, kuvendi pas votimit me 33 vota “për” 1 votë “kundër” dhe 1 votë “abstenim” aprovoi këtë:***



## R E N D   D I T E

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e kuvendit të komunës, i datës 30.05.2019;
2. Shqyrtimi i Draft Kornizës Afatmesme (KAB) për vitet 2020-2022;
3. Shqyrtimi i Propozim - vendimit për emërtimin e Qendrës rinore;
4. Shqyrtimi i Draft- planit për përfshirjen e komuniteteve rom dhe ashkali në Komunën e Vushtrrisë (**Shqyrtimi i dytë**);
5. Shqyrtimi i Informatës mbi inspektimin e bizneseve në Komunën e Vushtrrisë;
6. Shqyrtimi i Informatës rreth procedurës së legalizimit të objekteve;
7. Shqyrtimi i kërkesës për përkrahje financiare;
8. Të ndryshme.
  - a). Shqyrtimi i Propozim - vendimit për transferimin e mjeteve buxhetore të komunës në kategorinë e pagave;
  - b). Shqyrtimi i Propozim - vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit për themelimin dhe përbërjen e Komitetit për Politikë dhe Financa;
  - c). Shqyrtimi i Informatës lidhur me verifikimin e procesit të shpërndarjes së subvencioneve dhe granteve.

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e kuvendit të komunës, i datës 30.5.2019

*Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime aprovoi procesverbalin nga mbledhja e rregullt e kuvendit, e datës 30.5.2019.*

2. Shqyrtimi i Draft Kornizës Afatmesme (KAB) për vitet 2020-2022

**Mejreme Ismajli, anëtare e kuvendit** - duke iu referuar faqes 7 të dokumentit në fjalë, ku flitet për mirëmbajtjen e ambientit, ceku se duhet të kemi më shumë hapësira gjelbëruese. Pastaj në faqen 30 rregullimi i hapësirave të Qendrës për punë sociale, në këtë të futen edhe projektet për rregullimin e hapësirave në QMF dhe AMF-të nëpër fshatra.

**Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë “unanime” vendosi me sa vijon:**

**1. Me këtë vendim aprovohet Korniza Afatmesme Buxhetore 2020-2022 e Komunës së Vushtrrisë, konform Qarkores Buxhetore 2020/01, e lëshuar nga Ministria e Financave, me të cilën caktohen kufijtë buxhetor të buxhetit të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2020-2022.**

**2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa.**

**3. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit dhe nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit.**

### 3. Shqyrtimi i Propozim - vendimit për emërtimin e Qendrës rinore

**Bahrije Ademi Murati, anëtare e kuvendit** - pasi përgëzoi drejtoreshën për kulturë, dhe nënkryetarin e komunës, për punën e mirë që kanë bërë në organizimin e manifestimeve për nder të 20 vjetorit të çlirimit të Vushtrrisë, shtoi se Vushtrria këtë vit është bërë me shesh dhe me shtatoren e patriotit shqiptar Hasan Prishtina. Po ashtu i vjen shumë mirë që në këtë jubile është nderuar me çmimin “Nderi i qytetit” Ali Januzi një ish-ushtar i UÇK-së dhe veprimtar i çështjes kombëtare. Lidhur me emërtimin e Qendrës rinore me emrin e çiftit Buçinca, shtoi se grupi kuvendar i LVV-së do ta përkrah këtë propozim pasi që ky çift me vite të tëra ka kontribuar për arsimin shqiptar qoftë si mësime të mësimdhënës e po ashtu edhe si udhëheqës të arsimit shqip në vitet më të vështira të mbijetesës së shkollës shqipe. Mandej shtoi se ky çift ka dhënë kontribut edhe në kulturën e komunës pasi kanë qenë pjesëmarrës, akterë, por edhe drejtues të Shtëpisë së Kulturës “Hasan Prishtina”. Në fund vlerësoi lartë punën e këtij çifti në emancipimin e vajzave shqiptare gjatë viteve të 90-ta.

**Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit** - tha se veprimi i kryetarit të komunës për emërtimin e kësaj qendre e ka vënë në pozitë të keqe kuvendin dhe anëtarët e tij, pasi që në këtë qendër është bërë përpunimi i një pllake dhe zbulimi i saj me emrin e çiftit Buçinca, andaj tani është absurde të propozohet një emër tjetër kur dihet se kësaj qendre veç i është vënë emri, por pa vendim të kuvendit, kurse tani po tentohet të formalizohet kjo çështje përmes kuvendit. Në fund kërkoi që në biografi të futet edhe periudha siç ai e vlerësoi periudha e ndritur e Fahri Buçincës në drejtimin e Burgut të Smrekonicës.

**Hysni Gërguri, anëtar i kuvendit** - tha se ka respekt të veçantë për çiftin Buçinca për kontributin e tyre të madh në fushën e arsimit dhe kulturës në komunën tonë, por vlerësoi se procedura e cila është ndjekur për emërtimin e kësaj qendre ka qenë antiligjore, pasi emërtimi është bërë pa vendim të kuvendit, kurse tani është sjell në kuvend propozimi për emërtimin e kësaj qendre. Lidhur me këtë çështje kërkoi mendimin e zyrës ligjore, për faktin se me sa di ai asgjë nuk ka qenë urgjente që ky emërtim të bëhet para mbajtjes së mbledhjes së kuvendit, dhe gjithashtu ai nuk e di që ndonjëherë nga praktika ka ndodhur që një institucion të emërtohet me emrin e një personaliteti derisa ai është gjallë.

**Albanez Tahiraj, zyrtar ligjor** - tha se në bazë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, është kompetencë e kuvendit emërtimi i rrugëve, rrugicave dhe vendeve tjera publike, andaj një propozim i tillë duhet t'i nënshtrohet votimit tani.

**Melihate Basholli-Latifi, anëtare e kuvendit** - tha se të gjithë në kuvend janë në dijeni për kontributin e dhënë nga çifti Buçinca, në fushën e arsimit e veçanërisht kontributi i tyre spikat në kthimin e vajzave shqiptare në procesin mësimor. Tutje shtoi se ky çift meriton të jetë në atë qendër dhe kjo është mirë që është bërë. Por megjithatë, ajo njoftoi se atë ditë kur është bërë emërtimi i kësaj qendre ka qenë aty në sajë të një pune tjetër, dhe nga aty e ka kuptuar se po bëhet emërtimi i qendrës, gjë kjo që nuk është në rregull pasi anëtarët e kuvendit të paktën është dashur të kenë ftesë për këtë ngjarje. Në fund tha se e përkrah emërtimin e kësaj qendre me emrin e çiftit Buçinca, por është kundër procedurës që është udhëhequr për emërtimin e kësaj qendre, andaj për këtë kërkoi shpjegime nga zyra ligjore.

**Besim Muzaqi, nënkryetar i komunës** - në cilësinë e udhëheqësit të këshillit organizativ për manifestimin për nder të 20 vjetorit të çlirimit të Vushtrrisë, ceku se ndjenë për obligim të jap sqarime sa i përket çështjeve të ngritura nga anëtarët e kuvendit. Në këtë rrafsh shtoi se paraqitja e propozimit është për herë të parë para kuvendit dhe vendimi merret për herë të parë sot, kurse

gjatë ditëve të “Hasan Prishtinës” është paraqitur propozimi dhe nuk ka asnjë vendim, sepse vendimi merret sot, ndërsa lidhur me ftesën njoftoi se të gjithë kanë qenë të ftuar.

**Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit** - tha se nuk kanë dilemë sa i përket kontributit të çiftit Naxhije dhe Fahri Buçinca, dhe për këtë njoftoi se do ta përkrahin këtë vendim, mirëpo janë kundër formës në të cilën është bërë emërtimi i Qendrës rinore. Pastaj shtoi se kryetari i komunës në bazë të ligjit ka të drejtë të propozojë emra për emërtimin e institucioneve publike, rrugëve dhe shesheve të qytetit, por jo të vendos emra. Në këtë formë kryetari i komunës i ka tejkaluar kompetencat e tij dhe është duke e sfiduar kuvendin, por ndoshta kryetari i komunës ka logjikuar diçka tjetër. Mandej vlerësoi se grupi kuvendar i PDK-së assesi nuk do të bie në gracka për mos ta përkrahur këtë propozim, sepse ky çift është eminent për Komunën e Vushtrrisë. Në këtë kontekst shtoi se është e pajustificueshme se si kryetari i komunës merr vendime arbitrare pa konsultuar askënd dhe duke shkelur dispozitat ligjore lidhur me kompetencat e tij. Nëse kjo çështje ka qenë e natyrës urgjente, atëherë ekziston mekanizmi dhe për këtë është dashur të thirret mbledhje e jashtëzakonshme për të vendosur për këtë propozim. Lidhur me këtë shtoi se kryetari i komunës është duke u sjellë sikur të jetë pronar i kuvendit. Në sajë të ligjit kryetari i komunës e ka të përcaktuar kompetencën dhe përgjegjësin, por ai është duke i keqpërdorur ato, por gjithashtu ai është duke i keqpërdorur edhe anëtarët e kuvendit, por edhe anëtarët nga koalicioni i tij qeverisës. Në këtë relacion nuk duhet të sfidohet kuvendi, anëtarët e tij, koalicioni qeverisës dhe as vetvetja e tij, sepse interesi i përgjithshëm i qytetit është që vërtet me u vlerësuar personalitetet siç është çifti Buçinca. Në fund kërkoi që herëve tjera mos të sfidohet kuvendi në këtë formë por sjellja e kryetarit të jetë konform ligjit.

**Hysni Gërguri, anëtar i kuvendit** - tha se askush nuk është kundër personaliteteve të çmuara të Komunës së Vushtrrisë siç është çifti Buçinca, dhe shtoi se nëse kjo çështje ka qenë e natyrës urgjente, atëherë është dashur të ftohen shefat e grupeve kuvendare për t’u dakorduar dhe votimi në kuvend do të ishte formal. Në vazhdim ai vlerësoi se edhe përkundër faktit që kryetari i komunës është bashkëpartiak i tij ai prapëseprapë është kundër shkeljes së ligjit. Në fund tha se do ta përkrahin këtë propozim me kusht që gjërat e tilla të mos përsëriten në të ardhmen.

**Lorik Maxhuni, anëtar i kuvendit** - tha se nuk e pëlqen idenë e votimit me kusht, por në këtë kontekst nuk do mend që nuk janë personat adekuatë për të bërë emërtimin e Qendrës rinore. Pastaj shtoi se çifti Buçinca meriton më shumë se kaq dhe ideja për emërtimin e Qendrës rinore me emrin e çiftit Buçinca i ka pëlqyer shumë. Mirëpo përkundër kësaj në situatën se si e ka sjellë kuvendin kryetari i komunës nuk e di se si ta kualifikojë këtë gjendje me çfarë terminologjie, për faktin se mbledhjen e kaluar citoi të ketë lënë një mesazh për kuvendin: “të gabosh është njerëzore, por të gënjesh është djallëzore” andaj faktet po dalin se kryetari i komunës është një mashtrues. Ai koalicionin qeverisës e mashtron çdo ditë me një fjalë ai është kokrra e mashtruesit dhe e vërteta e tij po bëhet çdo ditë e më shumë e vërtetë për të gjithë.

**Xhafer Tahiri, kryetar i komunës** – tha se për të gjithë ata që mendojnë sikur anëtari i kuvendit Lorik Maxhuni, atij si kryetar i vjen shumë keq, dhe shtoi se këtë njeri ashtu se si e ka edukuar babai dhe nëna e tij të cilët pas mbledhjes së kaluar i dërgojnë mesazhe duke kërkuar falje për sjelljet e birit të tyre, duke deklaruar se nuk është Loriku të cilën ata e njohin. Pastaj vazhdoi duke bërë pyetje z.Maxhuni a keni deklaruar në Agjencinë antikorrupsion që keni punuar me kontratë mbi vepër në ARC dhe e ke lëshuar punën duke shkelur ligjin, për faktin se keni shkuar një muaj ditë dhe më vonë nuk jeni paraqitur në punë duke deklaruar se aty ju ka dërguar shefi i juaj Kadri Veseli. Mandej ai vlerësoi se i vjen shumë keq për këto sjellje dhe nivelin e edukatës së Lorik Maxhunit dhe pret që edhe pas kësaj mbledhjeje babai i tij t’i shkruajë sërish për kërkim-faljeje në emër të tij, në të kundërtën ai nuk pranon të merret me të për faktin se është nivel shumë i ulët me



minimum edukatë, është një dështak i llojit të vet që shkon këtu e deri në Vjenë e nuk mund ta përfundojë një fakultet dhe kështu kthehet prapa. Për sa i takon procedurës për emërtimin e Qendrës rinore me emrin e çiftit Buçinca, njoftoi se ky propozim ka ardhur nga njerëz të respektueshëm dhe të rëndësishëm që kanë peshë e aktivitet në këtë shoqëri dhe në këtë qytet, duke pasur parasysh moshën e tyre, ideja ka qenë që të bëhet diçka pak më ndryshe sesa që bëhet zakonisht në Kosovë që nderohen njerëzit pasi që ata vdesin dhe pse ky çift mos të nderohet për së gjalli, kur dihet fare qartë që kontributi i tyre ishte i jashtëzakonshëm ku mëse 900 vajza kanë marrë bursë nga fondacioni “Buçinca”, dhe përsëriti se njerëz me rëndësi të qytetit kanë propozuar pas mbledhjes së kaluar, duke marrë për bazë edhe moshën që emrin e këtij çifti ta mbajë Qendra Rinore e Vushtrisë, dhe ky është një mesazh shumë i mirë edhe për të rinjtë tanë se kur punon mirë të vlerëson një qytet. Pastaj arsyetoi se ky çift ka një moshë të shtyrë dhe ata në njëfarë forme a i mban mosha apo jo, tjetër është fakti se po atë ditë kur është zbuluar pllaka ka qenë një sesion shkencor në Qendrën rinore ku ka referuar edhe Fahri Buçinca, për të cilin ka pasur ftesë, por nuk është ditur deri në fund se ai a do të marrë pjesë për shkak të shëndetit të tij, dhe ideja ka qenë që atij çifti t’i bëhet një befasi e këndshme duke zbuluar pllakën, dhe për të konfirmuar se nuk kemi shkelje të procedurave, po atë ditë që është zbuluar pllaka po atë ditë është sjell propozimi në kuvend dhe kjo tregon se atë ditë nuk është marrë kurrfarë vendimi, por vetëm është propozuar. Tani në këtë mbledhje plenare të kuvendit, po bëhet aq shumë zhurmë vetëm për inati ndaj kryetarit të komunës për faktin se ka bërë një propozim të qëlluar. Kjo është kështu për faktin se gjatë 10 viteve të qeverisjes së PDK-së asnjë shesh apo rrugë kryesore nuk mban emrin Ibrahim Rugova apo Ahmet Krasniqi, bile për ta bërë akoma më të parëndësishëm figurën e Ahmet Krasniqit një rrugë në fshatin Zhilivodë mban emrin e tij, dhe kjo është bërë nga pushteti i kaluar.

*Pas shkëmbimit të disa akuzave dhe kundërakuzave mes kryetarit të komunës dhe grupit kuvendar të PDK-së, kryesuesi i kuvendit e kishte ndërprerë mbledhjen e kuvendit, për të vazhduar më vonë.*

**Lorik Maxhuni, anëtar i kuvendit** - tha se duke parë sjelljet e kryetarit të komunës z.Tahiri, si dhe klimën politike që ai e ka instaluar në kuvend, vlerësoi se e neveritin thellë sjelljet e tilla denigruese dhe tendencat e kryetarit për ta nënshtruar kuvendin dhe për ta shtri ndikimin tek çdo anëtar i kuvendit. Si rezultat i kësaj ai vlerësoi se ndihet keq që është në kuvend kur ka të bëjë me një njeri siç është kryetari aktual i komunës, dhe kjo dita ditës po provohet se ky njeri nuk është personi adekuat për ta udhëhequr Komunën e Vushtrisë. Pastaj duke iu referuar diskutimit të kryetarit të komunës, ceku se kontrata për shërbime të veçanta është mekanizëm ligjor, për angazhim për kryerjen e shërbimeve të caktuara, por nuk është marrëdhënie pune, andaj ai ka qenë i angazhuar në baza ligjore dhe në pajtueshmëri me ligjin sa i përket punës së tij në ARC. Në këtë kontekst sqaroi duke deklaruar se dëshiron të përgënjeshtrojë kryetarin e komunës, se ai e ka bërë deklarin në Agjencinë Kundër Korrupsionit sa i përket angazhimit të tij me kontratë për shërbime të veçanta në ARC dhe kjo mund të vërtetohet shumë lehtë nga kushdo qoftë duke klikuar në faqen zyrtare të kësaj agjencie. Por në të vërtetë si të ia bëjmë kur kryetari nuk e deklaroi se ai dhe familja e tij jetojnë në pronë publike d.m.th është uzurpator i pronës publike. Pastaj kërkoi nga ana e kryesuesit të kuvendit që të ia tërheq vërejtjen kryetarit të komunës duke e përjashtuar nga mbledhja kur ky i fundit i kërcënon anëtarët e kuvendit. Në fund sa i përket prononcimit të kryetarit të komunës, se babai i Lorikut kishte kërkuar falje në adresë të kryetarit të komunës për gjoja se deklarimit e tij në kuvend dhe qëndrimet e tij njoftoi se kjo është sërish një gënjeshtëri e kryetarit,

për faktin se e vërteta është se kryetari i komunës kishte dërguar dy persona me qëllim negocimin e mendimit dhe për ndryshimin e qëndrimeve në kuvend, por që ishte refuzuar nga ana ime.

**Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit** - tha se ndihet keq për shkak të sjelljeve dhe të fyerjeve në baza personale të disa anëtarëve të kuvendit dhe kryetarit të komunës, andaj për këtë propozoi që pika e rendit të ditës propozim-vendimi për emërtimin e Qendrës rinore të shtyhet për mbledhjen e radhës, për faktin se konsideron se nuk ka ambient për të votuar ose mos votuar kjo pikë. Përfundimisht vlerëson se për këtë çështje duhet të ulen të gjitha grupet kuvendare dhe të marrin një vendim për emërtim për faktin se kjo çështje nuk ka kurrfarë urgjence dhe mund të vendoset edhe në mbledhjen e radhës të kuvendit. Në fund tha se kryetari të komunës të gjithë në kuvend ia thanë, madje edhe anëtarët e partisë së tij se kishte bërë shkelje kur kishte bërë emërtimin e asaj qendre, mirëpo ai nuk është në gjendje të kërkojë falje për shkak të krenarisë së madhe që ka, dhe kjo krenari e sjellë komunën në gjendje çfarë është, e që fatkeqësisht për këtë do të pendohen edhe ata njerëz të cilët e kanë votuar këtë kryetar.

**Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit** - tha se ndihet i zhgënjyer me metodën e qeverisjes që ka zgjedhur qeveria aktuale e Vushtrrisë, ku absolutisht nuk ka funksionalizim të ligjit, ku ka keqpërdorim të pozitës zyrtare, ka tejkalim të kompetencave dhe autorizimeve që i njohin ligjet në fuqi sa i përket pozitës së kryetarit të komunës, ka emërime politike nga ana e kryetarit të komunës, të cilat më vonë po reflektojnë keq në kompaninë "Uniteti" pastaj ka pretendime për revanshe politike edhe pse institucioni i kryetarit të komunës do të duhej të ishte unifikues e jo përçarës. Tutje vlerësoi se ai personalisht, por edhe grupi kuvendar i PDK-së, kanë pasur debate edhe konsulta me anëtarin e kuvendit z. Lorik Maxhuni, ku kishte pasur vlerësime se ndoshta gjuha dhe fjalori që kishte përdorur ky i fundit ka qenë i rëndë, por ndoshta jo i duhur, por ai u zotua se që nga sot më ky kryetar nuk do të kursehet por do ta ballafaqojmë me fakte dhe me të vërtetat për të bëmat e tij kundër interesave të Komunës së Vushtrrisë. Për këtë ai falënderon bashkëpartiakun e tij z. Maxhuni për atë se ai qysh në fillim e kishte identifikuar dhe ditur fytyrën e vërtetë të kryetarit aktual, për faktin se ky nuk meriton të jetë kryetar i komunës, nuk meriton kurrfarë bashkëpunimi, është injorant, është i nivelit shumë të ulët, uzurpator, dhe për këtë e ceku se nga Drejtoria e Kadastrit, kanë kërkuar raport dhe kjo është hera e tretë që e potencon për emrat e personave që kanë uzurpuar pronë publike dhe ky raport nuk është ofruar sepse sipas të gjitha gjasave ka frikë që t'i bëjë publike këto fakte, sepse afër 2 apo 3 hektarë tokë komunale i ka të uzurpuara kryetari i komunës së bashku me familjen e vet, dhe këto nëse drejtori nuk i sjell para kuvendit, atëherë ato t'i sjellin ata me numra të parcelave dhe në këtë kontekst do të shikohet mundësia që të hapen edhe procedurat tjera ligjore ndaj drejtorit të kadastrit, për faktin se ai ka obligim ligjor që t'i sjell raportet e kërkuara nga anëtarët e kuvendit. Mandej ceku se ai dhe grupi i tij kuvendar, ka dëshiruar gjithëherë që të jenë bashkëpunues dhe ka menduar që do ta arrijnë një unifikim si kuvend për t'u bërë zëri i qytetarëve ashtu qysh meritojnë. Mirëpo në këtë situatë në të cilën po e sjell kuvendin kryetari i komunës, paralajmëroi se nga sot nuk do të kursehet askush do të goditet me një opozitë të fuqishme secili në mënyrë individuale, andaj kërkoi që punët të kryhen me përgjegjësi, përndryshe goditjet do të jenë veç e veç dhe të njëpasnjëshme për veprimet dhe mosveprimet apo për keqpërdorimet të cilat janë bërë dukuri në komunën tonë, dhe kryetari i komunës me këtë taktikën e ikjes, të intrigave, gënjeshtreve dhe matrapazllëqeve nuk do të mund gjatë t'i rezistojë kësaj opozite të fuqishme që do të ia ofrojnë tash e tutje në kuvend. Nga kryesuesi kërkoi që mbledhjet e kuvendit të udhëhiqen konform ligjit dhe Rregullores së punës së kuvendit, sepse kryetari i komunës nuk është anëtar i kuvendit dhe ai nuk mund të vjen në kuvend dhe të mbajë ligjëratat politike. Gjithashtu kërkoi që të respektohet edhe vendi për ulëset, për faktin se kryetari i komunës dhe nënkryetari nuk e kanë vendin afër kryesuesit të kuvendit, për këtë kërkoi që të

respektohet Rregullorja e punës së kuvendit. Në fund tha se për pikën e rendit të ditës për emërtimin e Qendrës rinore, ceku se kryetari i komunës ka bërë shkelje ligjore sepse ai nuk e ka të drejtën e emërtimit të institucioneve publike, por vetëm të drejtën që të propozojë, për këtë njoftoi se ata do të votojnë në mënyrë të përgjegjshme sepse për figura të rëndësishme nuk do të mund t'i përçajë as kryetari dhe askush tjetër.

**Shpëtim Zhegrova, anëtar i kuvendit** - fillimisht kërkoi falje nga të gjithë anëtarët e kuvendit, për siç tha situatën e pakëndshme që u krijua në mbledhjen plenare të kuvendit, në ç'rast u ndërpre mbledhja, por ajo u ndërpre në mënyrë të njëanshme nga kryesuesi i kuvendit pasi që ndërprerja bëhet pasi të merret mendimi i anëtarëve të kuvendit. Tutje shtoi se ai paraprakisht kishte thënë disa të vërteta, për faktin se ai fillimit bindet para Zotit, dhe se asnjëherë nuk tenton ta përgojë apo ta linçojë dikë pa fakte dhe asnjëherë nuk flet pa pasur prova dhe argumente kurrë asnjëherë në jetën e tij. Pastaj ai vazhdoi duke pyetur kryetarin e komunës dhe koalicionin e tij qeverisës: se nëse nuk ka fakte që e inkriminojnë këtë qeveri, atëherë personalisht ai do të tërhiqet nga pozita e anëtarit të kuvendit dhe në tërësi nga jeta politike, por nëse kryetari i komunës ka fakte për keqmenaxhim, për korrupsion, për zhvatje dhe për haraç, atëherë ai do të jap dorëheqje? Kjo është e para, ndërsa e dyta pyeti anëtarët e koalicionit se a do të qëndroni në qeveri me një njeri i cili zhvatë dhe keqpërdorë çdo ditë qytetarin e Komunës së Vushtrrisë. Dhe në fund pyeti grupin kuvendar të LDK-së, konkretisht Dr. Hysni Gëgurin kryetar i Degës së LDK-së në Vushtri, se a do të distancohet nga një njeri i tillë si kryetari i komunës, sepse me veprimet e tij e ka sjell këtë gjendje çfarë ndodhemi sot. Mandej ai duke iu referuar në pyetjen e parashtruar nga z.Gërguri të cilën siç tha ai nuk e kishte pritur nga ana e tij ku ishte thënë në fillim të mandatit se për shkak të aprovimit të një lejeje ndërtimore është duke replikuar me kryetarin e komunës dhe këtë e konfirmoi se është e vërtetë, sepse është shantazhuar në forma të ndryshme, derisa është aprovuar ajo leje ndërtimore, por ajo procedurë nuk ka pasur asnjë shkelje ligjore ku krejt çka është dashur ka qenë pagesa e taksës për atë leje, dhe ajo është kryer. Mandej shtoi se shantazhet kanë filluar prapë dhe ato ai do t'i adresojë në institucione kompetente të drejtësisë apo në kuvendin e komunës, këto janë çështjet/ pyetjet të cilat ai ngriti dhe për të cilat tha se pret adresim me shkrim apo nëse ka vullnet ai mund të përballat edhe në një debat televiziv me kryetarin e komunës. Në fund tha se kryesuesi i kuvendit duhet t'i udhëheq mbledhjet konform rregullores, duke mbrojtur ligjshmërinë dhe duke mos lejuar qasje arbitrare nga askush.

**Hajriz Mustafa, anëtar i kuvendit** - tha se pas krijimit të kësaj atmosfere në kuvend është shumë vështirë të vazhdohet mbledhja, në këtë formë është duke u pamundësuar debati substancial për atë për çka janë të thirrur anëtarët e kuvendit për mbrojtjen e interesit të përgjithshëm, ku prej se ka filluar kjo mbledhje nuk është marrë asnjë vendim meritor përpos akuzave dhe kundërakuzave.

**Lorik Maxhuni, anëtar i kuvendit** - tha se pas krijimit të atmosferës jo të këndshme në kuvend, dhe pas fyerjeve dhe kërcënimeve të kryetarit të komunës ndaj anëtarit të kuvendit z.Ilmi Azemi, propozoi që mbledhja e kuvendit të shtyhet pasi që nuk ka kushte normale që kjo mbledhje të vazhdohet.

**Pas votimit të propozimit për shtyrjen e mbledhjes kuvendi me 12 vota "për", 16 vota "kundër" nuk e aprovoj propozimin për shtyrjen e mbledhjes.**

*Pas këtyre debateve, grupi kuvendar i PDK-së, dhe anëtari i kuvendit nga radhët e LB-së, lëshuan mbledhjen e kuvendit.*



Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me 22 vota “për” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë vendosi që Qendra Rinore e Komunës së Vushtrrisë të emërtohet me emrin e qiftit “Naxhije dhe Fahri Buçinca”.

2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet: Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.

3. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

4. Shqyrtimi i Draft- planit për përfshirjen e komuniteteve rom dhe ashkali në Komunën e Vushtrrisë (Shqyrtimi i dytë)

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 21 vota “për” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim aprovohet Plani Komunal i Veprimit për Përfshirjen e Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Komunën e Vushtrrisë 2019-2021.

2. Qëllimi i aprovimit të këtij plani është konsolidimi i infrastrukturës juridike me qëllim të arritjes së objektivave për integrimin e komuniteteve rom dhe ashkali, si dhe përmirësimi i statusit të këtyre komuniteteve në Komunën e Vushtrrisë.

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim Drejtoria për Arsim, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, si dhe Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.

4. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është dokumenti me emërtimin Plani Komunal i Veprimit për Përfshirjen e Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Komunën e Vushtrrisë 2019-2021.

5. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

5. Shqyrtimi i Informatës mbi inspektimin e bizneseve në Komunën e Vushtrrisë

6. Shqyrtimi i Informatës rreth procedurës së legalizimit të objekteve

7. Shqyrtimi i kërkesës për përkrahje financiare

**Albanez Tahiraj, zyrtar ligjor** - tha se për këto raste zyra ligjore edhe kësaj here jep mendim përfundimtar, për këtë çështje pasi që kemi shumë raste të kërkesave të tilla të natyrës së njëjtë, dhe për të njëjtat kërkesa nuk mund të kemi interpretime të ndryshme, pasi që rregullorja në fuqi për subvencione e ndalon këtë formë të subvencionimit. Pastaj sqaroi se kuvendi me vetiniciativë

e ka hartuar rregulloren ku janë përcaktuar edhe kompetencat për ndarjen e këtyre subvencioneve. Në këtë kontekst kuvendit i është hequr e drejta për të ndarë subvencione dhe kjo është bërë me vetiniciativë të anëtarëve të kuvendit, andaj në këtë rrugë nuk ka mundësi subvencionimi përmes kuvendit bazuar në rregulloren e cila është në fuqi. Nëse kuvendi e sheh të arsyeshme mund të iniciojë plotësim-ndryshimin e kësaj rregulloreje.

**Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit** - tha se babai i këtij studenti, është mësimdhënës dhe ai nuk i ka mundësitë financiare që t'ia financojë udhëtimin pasi është një shpenzim bukur i konsiderueshëm dhe kështu apeloj që të gjendet një modalitet për ofrimin e ndihmës për këtë student. Tutje shtoi se komuna duhet të jetë e kënaqur kur ka kësi studentësh që mund të përfaqësojnë në arenën ndërkombëtare.

**Agron Përçuku, anëtar i kuvendit** - tha se grupi kuvendar i LDK-së e mbështet këtë kërkesë, për ofrimin e ndihmës financiare për këtë student.

**Ali Januzi, anëtar i kuvendit** - tha se familja e këtij studenti vërtet janë në një gjendje të dobët ekonomike, dhe meqë ky student është i shkëlqyeshëm dhe do ta përfaqësojë komunën në këtë garë ndërkombëtare, atëherë është mirë që komuna të gjejë një formë adekuate për ofrimin e ndihmës financiare për këtë student.

**Abit Abiti, ZKF** - tha se duhet të kemi kujdes lidhur me nxjerrjen e vendimeve për aprovimin e kërkesave për subvencione, pasi shpesh po kemi vendime, por pa u siguruar mjetet financiare dhe kjo po shkakton probleme në zbatimin e atyre vendimeve. Pastaj ai sqaroi se në momentin kur po flasim nuk e kemi një raport të gjendjes së subvencioneve nëpër drejtoritë komunale.

**Besim Muzaqi, nënkryetar i komunës** - tha se kuvendi dhe qeveria komunale kanë role të ndara, por ai u zotua se nëse kjo kërkesë adresohet në Drejtorinë për Kulturë apo në Drejtorinë për Arsim, atëherë do të mundohen që këtij studenti t'i ofrohet ndihmë konform mundësive financiare. Ndërsa sa i përket vendimeve të kuvendit ato janë të pandikuara nga qeveria, por e vërteta është se në bazë të rregullores në fuqi kuvendi nuk e ka të drejtën të ndajë mjete financiare.

**Abit Abiti, ZKF** - njoftoi kuvendin për raportin e mjeteve financiare në kategorinë e subvencioneve, duke e cekur shumën e mjeteve të shpërndara nëpër drejtoritë komunale.

**Afrim Namani, drejtor i DA-së** - tha se në bazë të rregullores të cilën e ka aprovuar kuvendi, e ka autorizuar qeverinë komunale që të merret me çështjen e subvencioneve. Tutje shtoi se buxheti i cili është alokuar nëpër drejtoritë komunale nga kategoria e subvencioneve, paraprakisht është planifikuar se ku do të shpenzohet. Pastaj sqaroi se shumata e mjeteve prej 2500 € nuk mund të ndahet me vendimin e kujtdo qoftë për faktin se bazuar në rregulloren për subvencione kryetari i komunës ka të drejtë të ndajë mjete financiare deri në 1000 € për rastet për shërim.

**Faton Shabani, anëtar i kuvendit** - tha se duhet të ndërpritet kjo praktikë e cila po e sfidon kuvendin, me këto kërkesa të cilat i dërgohen kuvendit, edhe pse dihet fakti që në bazë të rregullores kuvendi nuk mund të ndajë subvencione. Qeveria komunale duhet t'i analizojë këto kërkesa dhe nëse ka mjete financiare atëherë t'i ndajë ato mjete konform mundësive dhe rregulloreve në fuqi.

**Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me 21 vota "për" vendosi me sa vijon:**

**Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më datë 27 qershor 2019, pas shqyrtimit të kërkesës së z. Avdush Zymberit për ofrimin e ndihmës financiare për djalin e tij Shpëtim Zymberi, i cili është përzgjedhur nga Fakulteti i Arteve - Universiteti i Prishtinës, që ta përfaqësojë Kosovën në një festival të orkestrës ndërkombëtare, i cili do të mbahet në Francë, andaj në këtë rast, Kryetari të komunës i parashtron këtë:**

## REKOMANDIM

Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë i rekomandon Kryetarit të komunës, që të sipërcekurit t'i ndajë mjete financiare konform mundësive financiare dhe ligjore.

## ARSYETIM

z. Avdush Zymberi nga fshati Pasomë Komuna e Vushtrrisë, ka kërkuar nga kuvendi i komunës që t'i ofrojë ndihmë financiare për djalin e tij Shpëtim Zymberin për mbulimin e shpenzimeve të udhëtimit, akomodimit, transportit dhe shpenzimet administrative në ambasadë (në vlerën total prej 2500 €), pasi që ky i fundit do ta përfaqësojë Kosovën në festivalin ndërkombëtar të orkestrit që do të mbahet në Francë nga data 13-21 korrik 2019.

*Rekomandohet që Zyra e Kryetarit, Drejtoria për Arsim, si dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa, t'i zhvillojnë procedurat e akordimit të kësaj ndihme financiare konform legjislacionit në fuqi.*

### 8. Të ndryshme

a). Shqyrtimi i Propozim - vendimit për transferimin e mjeteve buxhetore të komunës në kategorinë e pagave

**Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit** - pyeti se cila është arsyeja e transferimit të këtyre mjeteve nga një linjë buxhetore në një linjë tjetër, a ka të bëjë me teprica të mjeteve financiare në ndonjë drejtori komunale.

**Sylejman Mehulli, drejtor i DSHPS-së** - paraqiti sqarime lidhur me këto transfere, pasi që një prej drejtorive komunale që ka bërë kërkesë për transfer të mjeteve për paga, është ajo e shëndetësisë, përkatësisht QKMF-ja, pasi që vitin e kaluar është aprovuar Kontrata kolektive sektoriale për shëndetësi e cila ka një kosto të lartë buxhetore dhe granti specifik i shëndetësisë nuk ka kapacitetet financiare që të mbulojë këto shpenzime e sidomos obligimet që dalin nga kjo kontratë në rastin e pensionimit të punëtorëve shëndetësorë apo shpërblimet jubilarë. Nëse ky vendim nuk aprovohet ka indikacione se komuna do të paditet nga këta punëtorë dhe kontestet gjyqësore do t'i humbim.

**Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 21 vota “për” vendosi me sa vijon:**

**1. Me këtë vendim bëhet transferimi i mjeteve në kuadër të kategorisë së pagave dhe mëditjeve në shumën prej 71,500.00 € nga programet:**

- 1.1 Zyra e Kryetarit, kodi (16024), shuma.....10,000.00 €
- 1.2 Administrata – Vushtrri, kodi 16324, shuma.....7,000.00 €
- 1.3 Shërbimet kadastrale, kodi 65120, shuma..... 8,000.00 €



- 1.4 Planifikimi, urbanizmi, inspektimet, kodi 66425, shuma.....7,000.00 €
- 1.5 Shërbimet kulturore, kodi 85024, shuma.....19,000.00 €
- 1.6 Arsimi fillor, kodi 93690, shuma.....20,500.00 €

**2. Shumat në programet e cekura më lartë, transferohen në programin Shërbimet e Kujdesit Primar Shëndetësor, kodi 74450 – në shumën totale prej 71,500.00 €**

**3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa.**

**4. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.**

b). Shqyrtimi i Propozim - vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit për themelimin dhe përbërjen e Komitetit për Politikë dhe Financa

**Basri Menxhiqi, anëtar i kuvendit** - propozoi Teuta Shartarin për anëtare të Komitetit për Politikë dhe Financa, nga radhët e partisë Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës.

**Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 21 vota “për” vendosi me sa vijon:**

**1. Me këtë vendim bëhet ndryshimi dhe plotësimi i vendimit të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë me numër të protokollit Nr.01-23/18 i datës 25.1.2018, lidhur me emërimin e anëtarëve të Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF), ashtu që në vend të z. Lutfi Bilalli, nga radhët Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), emërohet znj. Teuta-Aruçi-Shartari, nga i njëjti subjekt politik.**

**2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Sekretaria e Kuvendit.**

**3. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit dhe nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit.**

c). Shqyrtimi i Informatës lidhur me verifikimin e procesit të shpërndarjes së subvencioneve dhe granteve

**Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit** - njoftoi se komisioni i themeluar nga kuvendi më datë 25.4.2019 në përbërjen si në vijim: Ymer Haradinaj - kryesues i komisionit, Argon Përçuku - anëtar, Fakete Dushi - anëtare, Kushtrim Hyseni - anëtar, Sadije Bajgora - anëtare, Basri Menxhiqi – anëtar, dhe Abdullah Vojvoda - anëtar, ka mbajtur gjithsej 6 takime, në ç’rast ka verifikuar dhe shqyrtuar dokumentacionin ku ndër të tjera ka vërejtur se më datë 11.3.2019, drejtori për EBPZHR z.Miran Halili ka formuar komisionin për shpërndarjen e serrave me këtë përbërje: Rabije Zahiti - kryesuese e komisionit, Selim Pllana - anëtar dhe Fitore Hyseni - anëtare. Këtë komision e ka

shfuqizuar kryetari i komunës me një vendim dhe themelon tjetër komision me këtë përbërje: Rabije Zahiti - kryesuese e komisionit, Sabit Mehmeti - anëtar dhe Medina Podvorica - anëtare. Po ashtu drejtori për DEBPZHR, z.Miran Halili më datë 11.3.2019 formon komisionin për shqyrtimin, vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve për projektin “grante për zhvillimin e sektorit privat” me këtë përbërje: Sabit Mehmeti-kryesues i komisionit, Ragbete Krasniqi-anëtare e komisionit dhe Avdyl Feka-anëtar. Në të njëjtën mënyrë kryetari i komunës z. Xhafer Tahiri me një vendim e shkarkon këtë komision dhe themelon një komision tjetër në përbërjen si në vijim:

Ragbete Krasniqi - kryesuese e komisionit, Betim Grabanica-anëtar i komisionit dhe Hamit Bejtullahu - anëtar. Pas këtyre gjetjeve komisioni kuvendar ka kërkuar opinion ligjor se: kush ka të drejtë në formimin e komisioneve në DEBPZHR dhe kemi marrë këtë përgjigje. Përgjegjës kryesor për formimin e komisioneve në kuadër të komunës është kryetari i komunës, i cili sipas legjislacionit pozitiv emërohet edhe si zyrtari kryesor administrativ. Komisioni po ashtu ka kërkuar opinion ligjor lidhur me çështjen se a kanë të drejtë të jenë anëtarë të komisioneve për ndarjen e subvencioneve dhe granteve zyrtarët komunalë të angazhuar me kontratë mbi vepër? Lidhur me kërkesën në fjalë udhëheqësi i Zyrës ligjore z.Ismet Gashi jep këtë opinion ligjor: vetëm zyrtarët e emëruar në zyrën e kryetarit, nënkryetarit dhe kryesuesit nuk mund të jenë anëtarë të komisioneve të themeluara nga kryetari dhe kuvendi (sipas nenit 10 pika 4 e Udhëzimit Administrativ MAPL numër 01/18 për Përcaktimin e Stafit Mbështetës në Komuna). Komisioni i formuar nga kuvendi ka verifikuar 127 dosje, të cilët kanë aplikuar për serra prej të cilave 40 janë përfitues, 5 në listën rezervë dhe të tjerët janë jopërfitues e që janë 82 raste. Komisioni ka gjetur se 13 nga përfituesit kanë dokumentacion jo të kompletuar dhe të tjerët kanë dokumentacion të rregullt, 34 kanë dokumentacion të rregullt dhe nuk janë përfitues dhe 48 nga jopërfituesit kanë mungesë dokumentacioni. Sa i përket përfituesve të granteve, komisioni ka konstatuar se janë 97 përfitues prej të cilëve 39 përfitues kanë dokumentacion të kompletuar në bazë të thirrjes për aplikim, kurse 58 nga përfituesit kanë dokumentacion jo të kompletuar, ndërhyrje në ofertë nga komisioni, si dhe zvogëlim të shumës së përfiturar në raport me kërkesën e bërë. Në fund ai i dha një këshillë miqësore kryetarit të komunës, duke shtuar se ky i fundit vetë i ka emëruar drejtorët e drejtorive komunale dhe në këtë kontekst nuk është e moralshme që kryetari i komunës më shumë të iu besoj anëtarëve të komisionit dhe zyrtarëve që janë të angazhuar me kontratë mbi veprën sesa drejtorëve të tij, të cilët përsëriti se vetë i ka emëruar. Pastaj vlerësoi se vendimet që i ka marrë për zhbërjen e komisioneve nuk i bëjnë mirë as zyrtarëve që punojnë në komunë dhe as drejtorisë që ka qenë kompetente për zhvillimin e këtij procesi dhe as vetë kryetarit të komunës. Ai para kuvendit parashtrroi raportin në vija të trasha, por sqaroi se për secilin rast janë hartuar raportet dhe janë dhënë informata relevante, andaj nëse anëtarët e kuvendit kanë paqartësi dhe dilema mund të bëjnë pyetje. Në emër të komisionit njoftoi se janë mbajtur disa mbledhje dhe komisioni ka shqyrtuar një material tepër voluminoz që ka marrë kohë, andaj për këtë kërkoi që të shqyrtohet mundësia për kompensimin e anëtarëve të këtij komisioni.

**Basri Menxhiqi, anëtar i kuvendit** - si anëtar i komisionit kërkoi që të ndërpritet procedura e ndarjes së granteve, sepse komisioni ka gjetur mjaft parregullsi, dhe në këtë rast kërkoi që organet kompetente të drejtësisë të merren me këtë rast. Ai kërkoi që raporti të votohet dhe si i tillë të jetë objekt i hetimit të organeve të drejtësisë.

**Abit Abiti, ZKF** - sqaroi se konform Ligjit të Financave Publike, komisionet komunale të ngritura ad-hoc, nuk mund të kompensohen, pasi që angazhimi i tyre llogaritet në kuadër të pagës që marrin.

**Agron Përçuku, anëtar i kuvendit** - tha se puna e komisionit akoma nuk ka përfunduar në tërësi, dhe shtoi se komisioni do të dalë edhe në terren për ta verifikuar gjendjen faktike të shpërndarjes

së subvencioneve, dhe pas konstatimit të gjendjes raporti për të gjeturat do të adresohet në organet kompetente.

**ç). Pyetjet e anëtarëve të kuvendit:**

**Agron Përçuku, anëtar i kuvendit** - duke u bazuar në një raport të Drejtorisë së Shëndetësisë, është evidentuar se numri i pacientëve në shërbimin e urgjencës gjatë ndërrimit të natës është tepër i lartë. Mjekët kontrollojnë 60 deri 70 pacientë brenda një nate, andaj në këtë kontekst shtrohet pyetja se si i realizojnë thirrjet për vizita shtëpiake, thirrjet e policisë në rast të aksidenteve, përpilimin e raporteve nga organet e drejtësisë, aplikimin e terapisë parenterale, injeksionet dhe infuzionet, kështu që është e domosdoshme të rritet numri i mjekëve në shërbimin e urgjencës në ndërrimin e natës. Pyetja e dytë si qëndron çështja me konkursin për emërimin e shefave të shërbimeve, ku gati qe një vit ka filluar shpallja e konkursit, dhe akoma disa prej këtyre udhëheqësve nuk janë emëruar, këtu a kemi të bëjmë me kredibilitetin e anëtarëve të komisionit, a ka anëtarë të komisionit që janë të shantazhuar për shkak të pozitës që mbajnë, si u zgjedh aq shpejt kryeshefi i administratës, dhe a ka qenë e nevojshme kjo pozitë pasi që në Qendrën e mjekësisë familjare, ka qenë shefi i personelit i cili i ka ushtruar përgjegjësitë e administratës.

**Sylejman Mehulli, drejtor i DSHPS-së** - tha se sa i përket shërbimit të urgjencës dhe nevojës së shtimit të numrit të mjekëve gjatë ndërrimit të natës, ceku se nga raporti javor i QKM-së nuk mund të dini se sa raste nga rastet e tërësishme të urgjencës kanë qenë në ndërrimin e natës dhe sa janë në ndërrimin e ditës, pra kjo nuk mund të nxirret me numër se a janë 60 apo 70, ndoshta janë më tepër apo më pak, por si e dhënë nuk qëndron dhe për këtë demantoi anëtarin e kuvendit. Urgjenca pas orës 20:00 është e vërtetë që është e ngarkuar dhe rrjedhimisht ka nevojë për mjekë shtesë dhe Drejtoria e Shëndetësisë e përkrah një politikë të tillë. Ai shtoi se politikat shëndetësore janë për rritjen e numrit të mjekëve kudo që ka nevojë, por prioritare duhet të jetë rritja e numrit të mjekëve në qendrat familjare në bashkësitë lokale, ashtu që orari i punës të bëhet 5 ditë në javë. Mandej funksionalizimi i ndërrimit të dytë të urgjencës ka implikime buxhetore, por për këtë mëtohet të rritet buxheti dhe të angazhohen në punë edhe 2 mjekë në shërbimin e urgjencës. Lidhur me konkurset e brendshme për pozitat e shefave në QKMF, është një çështje e brendshme e QKMF dhe kështu nuk hapet, nuk drejtohet dhe procedurat nuk zhvillohen nga ana e drejtorisë komunale, por nga menaxhmenti i QKMF-së, duke u bazuar në Rregulloren për pozitat menaxheriale, dhe Udhëzimin Administrativ për Rregullimin e Pozitave në Sektorin Publik, vendet e punës, të cilat i kanë të planifikuara në buxhet, paraprakisht dhe janë vakante në pozicion, i plotësojnë përmes konkurseve të brendshme dhe për çfarëdo ankese apo vërejtje që mund ta kenë secili punëtor i QKMF-së mund t'i adresojë në organet përkatëse në komisionin e brendshëm të ankesave, por edhe në inspektorat.

**Agron Përçuku, anëtar i kuvendit** - sa i përket demantimit lidhur me numrin e pacientëve, shtoi se këtë numër të pacientëve e kanë marrë nga vetë doktorët që punojnë në shërbimin e urgjencës, dhe ceku se është imediate shtimi i numrit të punëtorëve shëndetësorë në shërbimin e urgjencës.


**Sylejman Mehulli, drejtor i DSHPS-së** - tha se është plotësisht legjitime kërkesa për rritjen e numrit të mjekëve, por për këtë duhet të kemi planifikim të buxhetit sepse kjo çështje ka një kosto financiare. Pastaj njoftoi se është duke përgatitur një master-plan ku do të jepej zgjidhje shumë problemeve në shëndetësinë e komunës.

**Abdullah Vojvoda, anëtar i kuvendit** -tha se është e vërtetë që në mjekësinë familjare kemi mungesë të mjekëve, për faktin se disa prej mjekëve ndodhen në specializime jashtë vendit. Por megjithëkëtë edhe me këtë numër të mjekëve nuk kemi ankese nga qytetarët dhe menaxhimi është




i mirë. Sa i përket urgjencës ajo e ka stafin e vet dhe punon në katër ndërrime, ndërsa ekipi i teknikëve është i trajnuar që edhe pa ndihmën e mjekut të dal në terren për ofrimin e ndihmës në rastet e aksidenteve dhe për ta sjell deri në Qendër të mjekësisë familjare. Në fund tha se duhet të lëshohet buxheti dhe të punësohen mjek të ri në qoftë se dëshirojmë të kemi shërbime më cilësore shëndetësore.

**Mbledhja përfundoi në ora 14:20.**

**Bastri Duraku**  
  
**Procesmbajtës**



**Nasuf Aliu**  
  
**Kryesues i Kuvendit**